UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/285
Datë: 8 / 6 / 2022

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", bazuar në nenin 19 paragrafi 1 të Statutit të UP-së dhe neneve 17-24 të Rregullores me nr. prot. 1/131, datë 1.6.2015, në mbledhjen e mbajtur më 7.6.2022, mori këtë

VENDIM

I. Shpallen zgjedhjet për zgjedhjen e pesë (5) anëtarëve të Këshillit Drejtues nga radhët e personelit të akademik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

II. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues fillon më 1 tetor 2022 dhe përfundon me datë 30 shtator 2025.

III. Secili anëtar i personelit akademik të Universitetit në marrëdhënie të rregullt pune ka të drejtë të kandidohet për anëtar të Këshillit Drejtues të Universitetit.

IV. Përjashtimisht nga pika III e këtij vendimi, nuk mund të kandidohen për anëtarë të Këshillit Drejtues për mandatin e përcaktuar si në pikën II të këtij vendimi: rektori, prorektori, dekani, prodekani, anëtari i Senatit, sekretari i përgjithshëm dhe sekretari i fakultetit.

V. Anëtari i Këshillit të Fakultetit, që zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit, duhet të heqë dorë nga anëtarësia në Këshillin e Fakultetit.

VI. Dokumentacioni për kandidim dorëzohet në zyrën e arkivit të UP-së, nga data 8-15 qershor 2022. Kandidatët duhet të dorëzojnë një letër motivimi dhe CV-në.

VII. Me të përfunduar të procedurës së kandidimit, komisioni zgjedhor prej tre (3) anëtarësh i formuar nga Senati, shqyrton dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur.

VIII. Komisioni zgjedhor përcakton nëse kandidatët e paraqitur i plotësojnë kushtet nga neni 18 i Rregullores me nr. prot. 1/131, datë 1.6.2015 të Senatit të UP-së.

IX. Lidhur me dokumentacionin e shqyrtuar, komisioni i paraqet raport Senatit, me propozim të listës së kandidatëve që i plotësojnë kushtet për kandidim.

X. Raporti i komisionit bashkë me dokumentacionin e kandidatëve i dërgohet anëtarëve të Senatit të paktën një javë para mbajtjes së mbledhjes zgjedhore.

XI. Në fillim të mbledhjes zgjedhore, Senati shqyrton raportin e komisionit zgjedhor dhe përcakton listën përfundimtare të kandidatëve që i plotësojnë kushtet nga neni 18 i Rregullores me nr. prot. 1/131, datë 1.6.2015 të Senatit të UP-së.

XII. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues bëhet me votim të fshehtë.

XIII. Vendimi duhet të publikohet në tabelat e shpalljeve të njësive akademike dhe në uebfaqen zyrtare të Universitetit.

XIV. Procedurat për votim dhe zgjedhje të pesë (5) anëtarëve të Këshillit Drejtues nga radhët e personelit akademik të Universitetit, janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në Rregulloren me nr. prot. 1/131, datë 1.6.2015 të Senatit të UP-së.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Anëtarëve të Senatit të UP-së,
3. Anëtarëve të Komisionit zgjedhor,
4. U.D. të sekretarit të përgjithshëm të UP-së,
5. Zyrës së TI-së, për publikim në uebfaqe,
6. Zyrës për buxhet dhe financa në UP.

Kryesues i Senatit të UP-së

Prof. dr. Naser Sahiti, rektor

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" • UNIVERSITY OF PRISHTINA • 1970